



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E  
TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 105 Prot.

Tiranë më 17.01.2020

REKOMANDIM

Nr. 01, datë 17.01.2020

PËR CAKTIMIN E PERSONIT TË KONTAKTIT

*(Mbi respektimin e detyrimeve ligjore në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale nga organet e administratës shtetërore)*

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 pika 1 gërma a/1,32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, në kuadër të mbikëqyrjes së aktivitetit të organeve të administratës shtetërore të Republikës së Shqipërisë, në cilësinë e kontrolluesve dhe në përmbushje të respektimit të parimeve dhe detyrimeve ligjore në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, me qëllim disiplinimin dhe sensibilizimin e këtij sektori;

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit vlerëson rëndësinë e aktivitetit të administratës shtetërore të Republikës së Shqipërisë në kuadër të impaktit që ka mbi qytetarët përpunimi i të dhënave personale nga ana e saj, në lidhje me ushtrimin e detyrave funksionale, me qëllim respektimin e detyrimeve ligjore përkatëse nga ana e kontrolluesve që veprojnë në këtë sektor.

Në nenin 2, të ligjit nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", përcaktohet se: "1. Administrata shtetërore është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore"... "3. Administrata shtetërore ka personalitet juridik publik dhe përbëhet nga struktura të organizuara në mënyrë hierarkike".

Në nenin 4 të ligjit nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", janë parashikuar edhe institucionet që përbëjnë administratën shtetërore: Kryeministria; ministritë; institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave; njësiti e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve; agjencitë autonome dhe administrata e prefektit.

Këto institucione konsiderohen subjekte përpunues të mëdhenj në kuptim të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.47, datë 14.09.2018 "Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha" të Komisionerit dhe si të tilla kanë detyrim plotësimin e të gjithë parashikimeve që burojnë nga baza ligjore e sipërcituar për sa i përket të dhënave personale që ato përpunojnë.

Nga detyrimet kryesore që buron nga baza ligjore e sipërcituar, është edhe përmbushja e detyrimit për njoftim dhe përditësimi i tij (neni 21, 22 i ligjit) si edhe caktimi i një personi të ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave personale nga organet e administratës shtetërore (në vijim person kontakti).

Zyra e Komisionerit gjatë ushtrimit të hetimeve administrative ka konstatuar se një numër i konsiderueshëm kontrolluesish (*institucione të administratës shtetërore*) nuk kanë "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale që kryejnë. Ky detyrim konsiderohet i përmbushur kur plotësohet në të gjitha elementët e tij. Një ndër rubrikat e këtij Formulari Njoftimi është edhe ajo e caktimit të një personi kontakti.

Në Kapitullin VI, të Udhëzimit nr.47, të Komisionerit, parashikohet se: "*Subjekti përpunues i të dhënave personale është përgjegjës për mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale të përpunuara. Cdo subjekt që i nënshtrohet këtij udhëzimi do të autorizojë me shkrim të paktën një person të ngarkuar, për të kryer këtë mbikëqyrje. Subjekti përpunues do të njoftojë Komisionerin për autorizimin e vetëm një personi të kontaktit, edhe në rast se ai mund të emërojë disa për mbikëqyrjen e brendshme të mbrojtjes së të dhënave personale. Nëse subjekti zëvendëson personin e kontaktit, ai duhet të njoftojë Komisionerin jo më vonë se 14 ditë nga data e zëvendësimit*".

Roli parësor i personit të kontaktit është të sigurojë që kontrolluesi (institucion i administratës shtetërore) të përpunojë të dhënat personale të stafit të tij apo të qytetarëve (referuar si subjekte të të dhënave personale), në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe akteve të tjera të nxjerra në zbatim të tij. Personi i kontaktit, jo vetëm është përgjegjës për mbikëqyrjen e brendshme të përmbushjes së detyrave që parashikon ligji nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, por gjithashtu shërben si një pikë kontakti në rastet kur subjektet e të dhënave personale drejtohen me ankesë për mënyrën e përpunimit të të dhënave të tyre personale.

Caktimi i personit të kontaktit përveç garancive të dukshme më të mira për subjektet e të dhënave personale është kontribut për një mbrojtje më të mirë të aseteve të informacionit me vlerë brenda kontrolluesit.

Një nga detyrat dhe përgjegjësitë e rëndësishme të personit të kontaktit është sigurimi i bashkëpunimit të nevojshëm me Zyrën e Komisionerit. Ai duhet të njoftojë në rastet kur kontrolluesi (institucioni) dështon në marrjen e masave të nevojshme për trajtimin e problemit në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në kohën e duhur.

Personi i kontaktit ka pavarësi në ushtrimin e detyrave të tij. Njoftimi i mangësive apo adresimi i një kërkesë nga personi i kontaktit në lidhje me përmbushjen e detyrave të kontrolluesit nuk mund të bëhet nxitje apo arsye për kryerjen e një veprimi nga ky i fundit, në dëm të personit të kontaktit. Theksojmë se, në rast se zëvendësohet personi i kontaktit institucioni duhet të vërtetojë se ky person ka dëmtuar ose ka përmbushur në mënyrë të pamjaftueshme detyrimet e tij, nuk ka përmbushur kushtet profesionale apo etike, etj. Personi i kontaktit duhet të zëvendësohet në rastin kur nuk vazhdon të jetë më pjesë e institucionit përkatës të administratës shtetërore. Në çdo rast, kontrolluesi duhet të caktoj një person tjetër kontakti dhe për këtë duhet të njoftojë përsëri Zyrën e Komisionerit me të dhënat e përditësuara të tij, ndryshim i cili pasqyrohet edhe në Formularin e Njoftimit.

Rregullorja 2016/679/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 27 prillit 2016 mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe mbi lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave (në vijim GDPR), e cila ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2018, i kushton rëndësi rolit të personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale në administratën shtetërore. Në nenin 37, të GDPR parashikohet se: *“Kontrolluesi dhe përpunuesi caktojnë një nëpunës për mbrojtjen e të dhënave në çdo rast nëse: (a) përpunimi kryhet nga një autoritet ose organ publik,.....”*.

Personi i Kontaktit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është një figurë e krijuar prej një kohe të gjatë në të drejtën e BE-së. Një ndër detyrimet kryesore me të cilat GDPR-ja ngarkon kontrolluesin (organet e administratës shtetërore) është caktimi i një Personi Kontakti për mbrojtjen e të dhënave personale (*në GDPR gjendet me termin nëpunës për mbrojtjen e të dhënave personale*).

Theksojmë se, mospërmbushja e këtyre detyrimeve, përbën shkelje të neneve 21, 22 dhe 27 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008, *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar si dhe Udhëzimit nr.47, datë 14/09/2018 të Komisionerit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 21, 22, 27, 30, 31 dhe 32 pika 1, të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar;

### REKOMANDOJ:

1. Zyra e Komisionerit kërkon të merren masa të menjëhershme nga ana e organeve të administratës shtetërore, për caktimin e një Personi Kontakti për mbrojtjen e të dhënave personale dhe përditësimin e të dhënave të tij në rast se ky person ka ndryshuar, në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr.47, datë 14/09/2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”*, të Komisionerit.

2. Ministritë e linjës të marrin masa për caktimin e personave të kontaktit edhe në organet e varësisë sipas detyrimeve të përcaktuara në pikën 1, të këtij rekomandimi.
3. Të njoftohet me shkrim pranë Zyrës së Komisionerit mbi të dhënat e personit të kontaktit të caktuar. Plotësimi i këtij detyrimi ligjor mund të jetë objekt hetimi administrativ në të ardhmen.
4. Në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 17.01.2020

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

